

BIBLIOTEKA


E

SHTETIT

DJH-1

C 13

GJIROKASTËR




Aleks Çaçi

AROMA
E TOKËS

POEZI

81H-1
- 913.

Aleks Çaçi



Aroma e tokës

POEZI

11744

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

A T D H E

Ti je gatuar me djersën,
që derdhën të parët gjatë shekujve,
me djersën që sot derdhim ne.
Ti ke në damarët e tu gjakun që u derdh për ty,
kallot e punëtorëve e të argatëve,
ke, o atdhe, të rrahurat e zemrës
të të gjithëve, qëkur ti linde
dhe deri sot,
ke eshtrat e atyre që ranë për ty,
eshtrat e nënës sime që të puthte çdo mëngjes
para se të shkonte në punë,
ti më ke mua që të rri ngjitur,
sytë e mi që të shikojnë thellë,
duart e mia që të mbajnë shtrënguar,
do më kesh, o atdhe,
përgjithmonë, në gjirin tënd.

NUK I HARROJMË!

Nënat tona gjithë natën përgjonin,
dridheshin nga të ftohtit.
Na u vranë shokët më të mirë.
Doja të numëroja lapidarët,
s'i numërova dot, si yjet.
Akoma kam në sytë e mi
gjurmët e vështrimit të tyre.
Nuk i harrojmë!

NË DORËN TIME

Në dorën time kanë mbirë rrudha,
nuk i numëroj dot.
Rri e mendoj, ç'ka zënë vallë?
Një herë, kur nëna ish sëmurë,
dorën ia vura mu në ballë.
Dhe që atëherë kjo rrudhë ruhet
Kur e shikoj, unë e di mirë,
një rrudhë e tillë kurrë nuk shuhet!

KËSHTU VAZHDONTE JETA

Në xhep mbaja një copë bukë,
gjithë ditën i mirrja erë, ngopesha.
Shkundja xhepin
dhe mblidhja thërrimet që më kishin mbetur.
Nëna zgjaste sahanin nga gardhi,
plaka Margalinë ia mbushte me miell.
Të nesërmen, nëna ia kthente.
Kështu vazhdonte jeta gjithnjë.
Më jep hua, të jap hua.
I kam fotografuar, o nënë,
duart e plakës Margalinë
dhe duart e tua.

NËNA NUK QAU

Nëna nuk qau kur i treguan kufomën e të birit.
N'ato çaste i doli përpara gjithë vegjëlia
dhe i tha se atë e vranë për lumturinë e të tjerëve,
për më shumë bukë,
për më shumë diell.
Ajo iu kthye të birit të vranë dhe i tha:
— Edhe të vdekur, nëna
brenda në gji të ka!

TË GJITHA MË MUNNONIN

Të gjitha më mungonin.
Dhe në shtëpi brenda, rrezet e diellit hynin
dhe dilnin me nxitim, nuk donin të qëndronin.
Kur vinte nata, zemra ime
nuk kishte qetësi.

Të gjitha më mungonin.
Vetëm kujdesi yt, o nënë,
dhe sytë e tu të ëmbël,
gjithnjë
afër më qëndronin.

LOTI

Nuk kam qarë kur s'kisha,
as kur ecja rrugëve, duke kërkuar punë,
as kur e ndjeva veten ngushtë,
kur donin të më vrisnin,
se doja të takohesha me dritën.
Qava vetëm, kur nëna qau,
se i kërkova bukë dhe s'më dha,
të flija, më tha.
Të nesërmen e pashë që qeshte,
me vështrimin e saj më mbushi me ëmbëlsi,
edhe atëherë, një lot më ra në tokë përsëri.

DHE UNË ME TË

Është e vërtetë. Atë ditë
isha dhe unë atje.
U ngrit dhe patronit me zemërim i tha:
— Nuk të duroj më, këtë ta dish,
s'punoj më dot për ty.
Dhe punëtori ngriti grushtin lart.
Ka qenë viti tridhjet' e gjashtë.
Dhe unë me të
rrugën e nisëm bashkë.